

MIMOZA KARAGJOZI KORE

**VEÇORI ARKAIKE GJUHËSORE NË TË FOLMEN E QYTETIT TË
GJIROKASTRËS KRAHASUAR ME GEGËRISHTEN E MESHARIT TË
GJON BUZUKUT**

Të folmet e veçanta ruajnë edhe sot tipare arkaike, të cilat përbëjnë një burim të rëndësishëm të dhënash për historinë e gjuhës shqipe. Në këtë artikull do të paraqesim disa prej këtyre veçorive të ruajtura në të folmen e sotme të qytetit të Gjirokastrës, të cilat i kemi vërejtur edhe në gegërishten e librit të parë të shqipes “Meshari” të Gjon Buzukut.

Gjuha shqipe konsiderohet si një gjuhë inovuese, por jo të dyja dialektet kryesore të saj kanë ecur krah më krah në këtë proces. Fillimisht toskërishtja pësoi një evolucion më të shpejtë se gegërishtja, megjithatë, në të gjenden ende tipare të krahasueshme me shqipen e teksteve të vjetra të Veriut, të cilat hedhin dritë e na shpjen në gjurmët e një shqipeje më unitare. Afritë e të dyja dialekteve si dhe shfaqja e dukurive të përbashkëta në to janë bërë objekt studimi edhe më parë nga studiues të ndryshëm, si: M. La Piana, J. Rrota, G. Petrotta, G. Meyer, N. Jokli. Më vonë ato u rimorën edhe nga E. Çabej, Sh. Demiraj, K. Topalli etj.

J. Rrota vuri re se me gjithë që ky libër është shkruar gegërisht, prapë kemi në të mënyra që janë sot të përdorura më fort nga krahu i Toskërisë¹.

M. La Piana pas analizës krahasuese që i bën veprës së parë në gjuhën shqipe, shkruar në gegërisht “Mesharit” dhe asaj të L. Matrangës, shkrimtarit më të vjetër të toskërishtes, vuri re një varg përkimesh mes gegërishtes së librit të parë dhe arbërishtes së Sicilisë, duke arritur në përfundimin se ekziston një ngjashmëri e madhe ndërmjet gegërishtes së vjetër të Buzukut dhe dialekteve të shqipes, veçanërisht në periudhën e tyre më të hershme, përpara ndarjes në dialektet moderne.² Ai vazhdon më tej arsyetimin e tij të ruajtjes së elementeve arkaike, mbështetur edhe në kriteret gjeografike, duke dalë në konkluzionin se në zonat periferike ruhen më mirë elementet gjuhësore të vjetra, të cilat sa më larg të jenë nga qendra e rrezatimit, aq më shumë konservatore dhe të huaja ndaj ndryshimeve paraqiten.

¹ J. Rrota, “Hylli i Dritës”, VI, 48.

² La Piana, *I dialetti siculo-albanesi*, in: “Studi linguistici albanesi. Varia 1949”, ribotuar në “Albanesi in Sicilia”/F. Giunta... [et al.]; a cura di Matteo Mandalà, A. C. Mirror, Palermo, 2003, f. 100 (conclusioni).

E. Çabej që studioi dhe analizoi gjerësisht veprën e parë të shqipes, arriti në të njëjtin përfundim se dialektet periferike ruajnë tipare më të vjetra se ato qendrore³. Inovacionet gjuhësore në gegërishte, sipas E. Çabejt, kanë filluar nga zonat qendrore të Gegërisë pas pushtimit turk të viseve shqiptare. Ai gjithashtu në trajtat e vjetra që vërente në veprën e Buzukut shprehej se “ka trajta dhe elementë leksikore të saj që për vjetërsinë që kanë rishfaqen dhe në anën më jugore të truallit gjuhësor të shqipes”⁴.

Në këtë punim do të përpiqemi të paraqesim disa veçori të përbashkëta arkaike të librit të parë në gjuhën shqipe dhe të folmes së qytetit të Gjirokastrës, ngase kemi bindjen se ndër tekstet e vjetra, të “Meshari” i Gj. Buzukut shfaqen me tepër tiparet e përbashkëta arkaike të të dyja dialekteve. Këto tipare arkaike i takojnë një periudhe të hershme të shqipes, të cilat mund të jenë qoftë të trashëguara nga faza më e hershme, qoftë inovacione të kryera paralelisht në të dyja dialektet në një periudhë të caktuar, gjithsesi paraletrare të gjuhës. Pikërisht se gjenden në të folmen skajore të toskërishtes, siç është e folmja e Gjirokastrës dhe në atë veriperëndimore, siç është gjuha e Buzukut, iu jep statusin “të vjetra” këtyre tipareve të përbashkëta.

Në vështrim të parë duket se e folmja e këtij qyteti dhe ajo e përdorur nga Buzuku te libri i tij, janë të largëta në kohë e në hapësirë si dhe iu përkasin skajshmërisht dy dialekteve të ndryshme. Por nga vëzhgimet tona mbi të folmen toske të qytetit të Gjirokastrës na rezultojnë shumë përkime me librin e parë, të cilat i gjejmë ende në brezin e vjetër të qytetit por që dalëngadalë bashkë me të po shuhën. Sigurisht disa prej tyre mund të gjenden edhe në të folme të tjera të Jugut, por ne do të përqendrohemi vetëm tek e folmja e këtij qyteti, në formën e saj të ruajtur, veçanërisht te brezi i moshuar. Shembujt për ilustrimin e kësaj të folmeje i kemi sjellë një pjesë nga vepra e M. Kokalarit⁵ dhe pjesën tjetër nga vëzhgimet tona.

Po përmendim shkurt veçoritë kryesore arkaike **në sistemin fonetik** që na rezultojnë të përbashkëta për këtë të folme dhe autorin e parë të shqipes, Buzukun. Në formën e saj të ruajtur, shqiptohet ende, madje jo rrallë, *ë*-ja e patheksuar fundore në fjalët preparoksitone, si: *fúndratë, gjithënj, nënënë, kóshtratë, zëmrenë, núsenë* etj. Këtë e vërejmë edhe te libri i parë. Përpara *dítësë Páshkësë* tue ditunë Jezu...(Mesh. 219/a); E mbasandaj shtiu ujë ndë një govadë, e zu me lam *kámbëtë* dishepujet (Mesh. 219/a) etj.

³ E. Çabej, *Disa aspekte të fonetikës historike të shqipes në dritën e gjuhës së Gjon Buzukut*, në: “Studime Gjuhësore”, VI, f. 183.

⁴ E. Çabej, *Personaliteti i autorit në dritën e veprës*, “Meshari”, Parathënie, f. 20.

⁵ Musine Kokalarit, është shkrimtarja e parë femër shqiptare deri në vitet ’60. Në veprat e saj: *Siç më thotë nënua plakë, Rreth vatrës* si dhe *Sa u tunt jeta* të përmbledhura në M. Kokalari, “Vepra”, Prishtinë, 2004, i është përmbajtur të folmes së qytetit të saj, veçanërisht asaj të grave gjirokastrite.

Te Buzuku del në /ë/ të theksuar dhe jo në /i/ siç ndodh me gegërishten e mëvonshme, numërori *një*: E tue him *ndë një* lagje (Mesh. 293/b); E kish *ntihem* bukëtë *ndë një* shportë (Mesh. 191/a).

Ndryshe nga përdorimi i përgjithshëm, ka raste që në të folmen e Gjirokastrës, kur fjala nis me një zanore të ndodhë shtesa e një /h/-je, në mënyrë jo sistematike, në fillim të fjalës (proteze) gjë që është e papërligjur edhe etimologjikisht, si: *has* “as, letër bixhozi”, *harij* “arrij”, *hezmer* “esmer”, *hunazë* “unazë”: Tani *harin* se luajtët, uluni në dhe. Florinj e *hunaza* i futi në një kuti që me kohë dhe ja vuri në xhep vajzës: “dhe ki mënden” i tha “s’e mos t’i humbasëç” (M. Kokalari. *Vepra*: 137, 200). Për mendimin tonë kjo dukuri duhet të jetë shumë e hershme dhe përkon me raste të tilla edhe në veprën e Buzukut, megjithëse duhet thënë që te Buzuku ka një lloj pasigurie në përdorimin e kësaj *h*-je në fillim të fjalës, sepse në të njëjtën fjalë herë e gjejmë e herë jo: *hesëllë* “esëll”, *hi* katërti “i katërti”, *here* “erë”, *hichunë* “ikunë”, p.sh.: shtinë ushtritë...ndë të *hikunë* (LXXI).

Duke lënë mënjanë diskutimet mbi interpretimin *h*-së në pozicionin në mes dhe në fund fjale që janë bërë me kohë nga gjuhëtarë të ndryshëm, po japim vetëm ato që shpjegojnë *h*-në nistore. J. Rrota⁶ është marrë shumë me arsyet e përdorimit të kësaj shkronje, sidomos në këtë pozicion. Ai bën përgjegjës ndikimin e drejtshkrimit të italishtes, ku kjo shkronjë edhe pse filloi të mos ndihej më, vazhdoi të shkruhej, kur fjala e marrë nga latinishtja e kishte pasur. Selman Riza⁷ shkon më tej në interpretimin e saj si përfaqësuese e tingullit përkatës të shpikur prej Buzukut për të realizuar një shqiptim “të shkoqur deri në afektacion”, me qëllim për të parandaluar çdo elizion ose aliteracion të zanores fundore të një fjale në ndeshje me zanoren nistore të fjalës pasuese, mënyrë që pastaj u përgjithësua në shkrim nga Buzuku pavarësisht nga çdo rrezik elizioni ose aliteracioni dy zanoresh në ndeshje. E. Çabej⁸ duke e studiuar thellë këtë dukuri te libri i parë për *h*-në nistore shprehet se pas gjithë gjasash lidhet me rrethanën që autori shkruan në një dialekt që kishte arritur në zhdukjen e *h*-së në çdo pozicion, ose së paku në një dobësim të fortë të shqiptimit të saj. Duke u nisur nga veçoria e të folmes së Shkodrës, konstatuar që më 1932 nga G. Lowman, B. Beci⁹, arrin në përfundimin se për *h*-në e fillimit të fjalës mund të jepet përgjigjja se kemi të bëjmë me një shprehje grafike të mbylljes glotale që shfaqet në mënyrë

⁶ J. Rrota, *Hulumtime dhe shenjime mbi Gjon Buzukun*, BShSh 3, 1956, f. 179.

⁷ S. Riza, *Nyjat e shqipes në tekstet e pesë autorëve tanë më të vjetër*, në: “Vepra”, 1, Prishtinë, 1996, f. 448-449.

⁸ E. Çabej, “*Meshari*”i Gjon Buzukut, Tiranë, 1968, f. 55.

⁹ B. Beci, *Rreth të ashtuquajturës “h” irracionale në veprën e Gjon Buzukut*, SF, 1991/3-4, f. 119.

josistematike në fillim të fjalëve përpara zanoreve. Sipas R. Ismajlit¹⁰, Buzuku nuk ka pasur bashkëtingëllore *h*, por ajo ka ekzistuar më parë në atë sistem fonetik dhe gjatë zhvillimit kishte lënë gjurmë në variantet e zanoreve të fjalët ku ndodhej në pozitë nistore. K. Topalli¹¹ për *h*-në nistore të Buzuku shprehet se rastet e përdorimit janë të pakta, kurse arsyet e sqarimit mund të jenë të shumta. Ai ka dhënë dy arsye, atë grafike, pra pasigurinë e përdorimit nga autori të shkronjës *h*, dhe nga ana tjetër, grafia mund të paraqesë një situatë fonetike të së folmes së Buzukut, duke anuar më tepër nga arsyeja e parë. Por, po ky studiuës¹² disa vite më vonë, duke shqyrtuar *h*-në nistore në shembuj të prurë nga Jugu, si *harrin, hoj, hurori* etj jep dhe një arsye tjetër se tingulli /h/ përdoret para një zanoreje për një hyrje të fortë e të aspiruar, në një shqiptim emfatik e me forcë afektive (khs. *hik, hec*).

Për mendimin tonë duket se e përbashkëta që mund të gjejmë në arsyetimet e mësipërme është se kjo dukuri më fort ka të bëjë me pasoja të humbjes së ndjenjës gjuhësore të *h*-së në të folme të shqipes, gjë që shpie në paravendosjen e një *-h*-je hiperkorrekte.

Përpara disa bashkëtingëlloreve të caktuara, si: /n/, /m/, /t/, /s/, /sh/ mbylltorja /q/ në një fazë më të vjetër të shqipes është spirantizuar rregullisht në /j/. Në të folmen e Gjirokastrës si dhe të Buzuku, në ndonjë rast, hasim formën e ndërmjetme të këtij evolucioni. Kështu fjala e latinishtes *directus* ka evoluar në *dëreq(t)* e pastaj *drejt*, si ndajfolje apo si parafjalë. Në Gjirokastrë ende gjejmë të përdorur në brezin e vjetër shprehjet: Erdhi *dreq* e në shtëpi.; Rri shtrëmbër e fol *dreq*. Tek Buzuku: E i tha Jezu: *dëreq* u përgjegje (Meshari, 291/b); E u në mos shtifsha dorënë teme *dëreq* zemëresë ti, u nuk besonj (Meshari, 319/a).

Përsa i përket grupit /lj/, Çabej¹³ vëren se Gegëria ka arritur me kohë në shkallën e *j*-së, sepse në tekstet e vjetra nuk ndeshet asgjëkundi në ndonjë gjurmë të *l*-së së mëparme. Në të folmen e Gjirokastrës kjo /l/ e hershme ruhet ende në fjalë si: *bilë, golë, fëmilë, shilë, apo fëlejnë* “gabojnë”, kurse të Buzuku ka evoluar në /j/: O zot gjithë ata që *fëjenjënë* mb udhë (Meshari, II, 253) etj.

¹⁰ R. Ismajli, *Grafia e Buzukut dhe disa çështje të sistemit fonetik të shqipes*, “Gjurmime albanologjike”, SShF VII.

¹¹ K. Topalli, *Rreth vlerës së shkronjës h në “Mesharin e Gjon Buzukut”*, SF, 1993/1-4, f. 97.

¹² K. Topalli, *Dukuritë fonetike të sistemit bashkëtingëllor të gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 95.

¹³ E. Çabej, *Gjon Buzuku dhe gjuha e tij* në “Buzuku dhe gjuha e tij”, Tiranë, 2005, f. 76.

Por, për sa i përket grupeve /lk/, /lg/, ato ndihen ende tek brezi i vjetër në këtë të folme, por i ndeshim edhe në librin e parë. Likuidja /l/ nuk është shndërruar ende në /j/ siç ndodh në gjuhën e sotme, p.sh.: *alkë* (ajkë), *balgë* (bajgë) etj. Është e njohur shprehja në qytet: Një *bulk*, vrau një *ulk* në malë të malit. Buzuku: Hinje se të vinjënë ditë qi të afëronetë *bulku* me korësit (Mesh. 299/a);

E rogetari që s'anshtë bari e që nukë janë dhentë e ti, aj në patë *ulknë* se vjen, le dhentë e ikën e *ulku* i grabitën e i përnda (Mesh. 253/b).

Në të folmen e Gjirokastrës, bashkëtingëllorja fërkimore (frikative) /s/, kur ka pranë saj një bashkëtingëllore të zëshme, shndërrohet në /z/, si: *z'bën*, *z'dua*, *z'di*, *z'gjej* etj. Dhe e vogël që qe *z'dëgjonesh* fare në shtëpi. *Z'di* ç'të thom, duro një çikë (M. Kokalari: 286, 44).

Një dukuri të ngjashme gjejmë edhe te Buzuku: ...qi ti z *do* mortnë e t përkatënuomit (54/a); ansish qish dukenë e ansish qi z *dukenë* (55/a); E si e kërkoi z *desh* m e piitë (211/a).

Te Buzuku gjendet hundorja qiellzore /nj/, tipar i vjetër i përbashkët i shqipes që sot është spirantizuar në /j/ në të dy dialektet. Këtë tipar e ka vërejtur dhe A. Omari¹⁴ kur krahason tiparet arkaike në veprën e Bogdanit me çamërishten. Te "Meshari": *mbë* qish anë muo të më *vinjë* ndima (19/a); e forco të *hinjënë*, aqë sa shtëpia eme të jetë *mbushunë* (Mesh. 279/a); të mos *kërkonjënë* ̣ darket sime (Mesh. 279/a); qi *banjinë* arkënë e Tinëzot (Mesh. 239/b).

Në të folmen e Gjirokastrës qiellzorja /nj/ gjendet ende në mbaresa shumësi si: *florinj*, *kushurinj*, *ftonj*, *gjinj*, *thonj*, *hunj*, *gjunj*, *kronjëre*, *pënj*, *udhinj*. Po kështu e gjejmë në formimin e shumësit të disa mbiemrave, si të *mbëdhinj* (të mëdhenj) etj. Gjendet gjithashtu edhe në patronimet: *Kadareanj*, *Shehanj*, *Koranj*, *Çabelianj* etj.

Nuk ka ndodhur metafoia /o/ : /e/ për krijimin e shumësit në të dyja modelet që kemi marrë në shqyrtim në mbiemrin e emëruar *i vogël*, Buzuku: E të mëdhenjtë kanë të mujtunë përmbi të *vogjëlit*? (141/a); Kur u jeshë i vogëlë, pors i të *vogjëlitë* flasë, pors i vogëlë gjegjeshë, pors i vogëlë kujtonje (111/b). Në Gjirokastrë: Kur pa gjithë të *vogjëlit* të mbledhur ati, uli tepsinë... Njëzet e pesë bëheshin burat e gjashtë të *vogjëlit* (M. Kokalari: 383, 183).

Në të dyja rastet gjejmë fonemën /u/, që s'është shndërruar në /y/ si në huazimin nga latinishtja *judicare*: Buzuku: përse anshtë kush ma lypën e kush

¹⁴ A. Omari, *Tipare arkaike në gjuhën e Bogdanit: përkime me të folmet e Jugut*, në: Wir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925-1992) gewidmet, Albanische Forschungen 29, Hgg. Von Bardhyl Demiraj, Harrassowitz Verlag, Wiesbaden, 2010, f. 356-374.

gjukan (187/b); e ti të ngadhënejsh muo kur të më *gjukanjsh* (Mesh. 505/a). Në Gjirokastrë si emër e gjejmë *gjukatë* ose *gjikatë*, kurse si folje *gjukoj*.

Në këtë të folme ende gjen, si një rast të veçuar, grupin /psh/ dhe jo /fsh/, si: Xhemilja mori di tre kapshata sa t'i bënte hatërë nënës. (M. Kokalari: 388), Buzuku: në mos dafsh *kapshatënë* ̣ gojet sote (Mesh. 65/b).

Çabej¹⁵ për këtë dukuri thotë: “Në Gjirokastrë thonë *kapshatë*, dhe kjo formë na del për çudi edhe te Buzuku, XXII. Po gjykimi i kësaj forme është i vështirë”.

Edhe disa dukuri fonetike ngjasojnë në këtë të folme me librin e parë. Kështu asimilimi progresiv /rn/ > /r/ e ndeshim ende në Gjirokastrë: Sa qava për *beharë*, s'qava për babanë (shprehje pop); *Hatërë* e kemi borxhe; Hir e dil e tund *peshqirë* (shp. pop.) Buzuku: E u shtiq *zjarë* qyteteve tynë (Mesh.307/b), qi ̣ barkut së shenë Mërisë Virgjënë deshe *Birë* tand (Mesh. 13/a); na tue pasunë përzanë *mishërierë* tande (135/b).

Një tjetër asimilim, por regresiv e vërejmë te grupi /tn/ > n: Në të folmen e Gjirokastrës del në shprehjet: S'nejh qeni të *zonë*; Është përmbi *mbrenë*; Buzuku: Për tenë *Zonë* (Mesh. 13/b).

Në të folmen e qytetit të Gjirokastrës, gjenden sot emra të përdorur me trajtë fonetike si te Buzuku edhe pse në të folme të tjera apo në shqipen letrare ata kanë pësuar me kohë ndryshime. Kjo analogji flet për faktin se në të folme të veçanta ndeshen ende dëshmi të krahasueshme nga pikëpamja diakronike me gjuhën e librit të parë në gjuhën shqipe. Kështu /r/ nuk është shndërruar në /l/ te fjala *palë* (çift): U bë dasmë na të di *par* anët (M. Kok.: 207); Buzuku: E vote, e muor dhjetë copë rgjand,e gjashtë mijë dukat t artë, e dhjetë *pār* petëka (153/a); qi të denjë janë me u bam *pār*, buri e gruoja (Mesh. 81/a).

Po kështu ruan trajtën më të vjetër që përdoret në këtë të folme ashtu si te Buzuku emri *mendje*: Buzuku: n a tue pasunë përzanë *mishërierë* tande, me *mende* e tue klene liberuom (135/b). Gjirokastrë: Janë me gjismë *mënde* (M. Kokalari: 48); U futnë brenda se na muarnë *mënden*. I erdhi në *mënde* (M. Kokalari:170).

Në brezin e vjetër (mbi 80 vjeç) mund ta hasësh ende trajtën më konservative e *shëtunë* “e shtunë”. *Të shëtunë* marim nusen; Erdhi *të shëtunë* dhe iku të dielnë. Këtë trajtë e gjejmë edhe te Buzuku, por me shtesë të një tingulli homorganik pas n-së: *E shëtunde* anshtë sod (Mesh. 133/a).

E mund të vazhdojmë edhe me analogji fonetike në emra të tjerë që ruajnë trajta më të vjetra në krahasim me gjuhën e sotme. Buzuku: derënë e kam mbërshelë, e *djelmtë* janë me muo (Mesh. 259/b); Lëvdoni, ju *djelm*,

¹⁵ E. Çabej, *Fonetika e Gj. Buzukut*, (Spirantet) në “Studime Gjuhësore”, VI, Prishtinë, f. 173 (shënim në fundfaqe).

Tinëzonë (Mesh. 25/a). Në Gjirokastrë: Ka di *djelm*, po dhe vajzën mos ta ndante (M. Kokalari: 398).

Ende në këtë qytet të moshuarit përdorin foljen *dhez për ndez*, p.sh.: Gjer në mes mbushur miell e shtatë qiri të *dhezur* (M. Kokalari: 240). Buzuku: Mer qirinë e n *dhezunë*, e ban ta ruonjësh pa të pushuom (Mesh. 79/b).

Folja *lavdëroj* në këtë të folme del në variantin më të vjetër *lëvdoj* (< *lavd*) si te Buzuku: *Lëvdoni* emënitë e Tinëzot (25/a); Denjou u *tÿtë të lëvdonj* (Mesh. 175/a). Gjirokastrë: Mos u mbur, mos u *lëvdo*, pas ca vitesh do të të shoh; *Lëvdonet* na hera.

Si **veçori në sistemin morfologjik** do t'i drejtohem si pari sistemit emëror ku do të veçonim ruajtjen e gjinisë asnjësore ende në të folmen e qytetit të Gjirokastrës, madje jo vetëm nga brezi i vjetër, por edhe ai më i ri. Gjinia asnjësore ka përdorim të dendur në emrat e lëndëve, si: erdhi *ujët*, zuri *brumët*, hoqi *dihët*, zjeu *mishtë*, s'më doli *miedhtë*, hodhi *djathëtë*, nxori *gjalpët*, hodhi *zahartë* (gr. ζάχαρη, sheqeri), p.sh.: Ika dhe unë se kam lënë tenxherenë në zjar dhe mos më digjet *mishtë* (M. Kokalari: 71); Sahanet plot, iu rinte *gjalpët* një gjisht (M. Kokalari, 51). Tek Buzuku gjejmë: e *ujëtë* që u t i ap, ka me klenë ndë gurë të gjallë (Mesh. II, 161); e kaha ke ti ata *ujë* të gjallë? (Mesh. 161/b); E përmbi ju banj të ritetë *mishtë* (Mesh. 237/b).

Në sistemin emëror, gjithashtu, do të veçonim një inovacion të përbashkët në rastin e mbaresës së zgjeruar së rrjedhore me *-shit*, të cilën E. Çabej e interpreton si "...refleks i indoeur. -su me anë të nyjës -t"¹⁶ e cila gjendet si te libri i parë shqip, ashtu edhe në të folmen e këtij qyteti në formë mbeturinore në disa shprehje popullore: *Ma kreve bukën hundëshit*. E gjejmë edhe te Musineja: ...se pastaj ma kren *hundëshit* dhe këtë të ardhur (f. 46), apo në shprehjen që përmend nga vendlindja E. Çabej në parathënien e "Mesharit" dhe që ende përdoret në këtë qytet, si: s'më *iku balta këmbëshit*. Po kështu e ndeshim në vargjet e këngës popullore: Nga më njohe që jam plak / *mjekërshit*, *mustaqeshit* / *dhëmbëshit*, *dhëmbadheshit*. Buzuku: ashtu edhe u *vepërashit* së këqijash na me ngjënuom ndë mendet (Mesh. 161/a); *q* *pleqshit* gjukatës (Mesh. 165/a).

Në sistemin rasor do të vërenim mungesën ende te brezi i vjetër i qytetit të mbaresës së re *-ve* të rasave të zhdrejta në emrat që mbarojnë me temë më bashkëtingëllore, si: Për kokë të *djelme*; Dëgjoje fjalën e *pleqe*; Folu *njerze*; Është vajzë e *Kokalaranje* dhe nuse e *Angonate*. Buzuku: Me u dhanë ndër duor të *njerëzet* (Mesh. 141/a); porsi gjithë mā *pleqet* popullsisë (Mesh. 167/a).

¹⁶ Gjon Buzuku dhe gjuha e tij, "Studime Gjuhësore", VI, Prishtinë, f. 71.

Një tipar tjetër të krahasueshëm edhe me të folmen e vendlindjes, Çabej e ka vërejtur edhe te disa forma arkaike të mbiemrit të pazgjeruar me prapashtesë. Kështu ai vëren te Buzuku mbiemrin “ *i lee për i lehtë...kurse në Gjirokastër me rrethe thonë edhe sot i lehë*”¹⁷ Buzuku: e të randëtë tem anshtë të *lë*. (Mesh. 371/a). Në brezin e vjetër, por edhe në atë të mesëm ende dëgjohet në këtë qytet shprehja: i qoftë balta *e lehë*; me kraha të *leha*.

Po kështu të pazgjeruar dalin edhe një varg mbiemrash si: *i afër, i largë, i tepër, i pakë*. Zgjerimi me *-t* është kryer në kohët e vona në gjuhën tonë, për t’i dalluar nga ndajfoljet përkatëse: Në qytet dëgjohet shprehja: I humbi të shumta e të *paka*; Është’ udhë *e largë* e shkreta, mirë thonë Amerikë. Gjellët i kishin me vënt, as të *paka* e as të *shuma* (M. Kokalari: 53, 51) E folmja e Gjirokastrës kishte lënë gjurmë edhe në të folurën e profesor Çabejt, prandaj gjejmë në të përdorime të tilla: ...duke u përmbledhur në disa të *paka* shprehje steriotipe.¹⁸ Buzuku: Ngrehu e ha, përse ke të *largë* udhë (Mesh. 89/b), Jam e *zeshkë*, ma jam bukurë formuom (Mesh. 302/a).

Një tipar shumë i hershëm i kësaj të folmeje, është se nuk shfaqet nyja e përparme *së* e një emri në gjinore, e një mbiemri a përemri, që vijnë pas një emri femëror në rasën gjinore, dhanore e rrjedhore të trajtës së shquar njëjës: i thuj *nënës djalit*; qe një burrë *i bilës tetos time; familjes tire*; pas *gjishes saj*. Kjo dukuri është në zhdukje në këtë të folme. Një dukuri e tillë gjendet rëndom edhe te Buzuku: E atë e madhështoi përpara *nmnersë anëmiqet* (Mesh. 319/a); Sa e madhe anshtë shtëpia e Tinëzot, e i madh anshtë vendi *i bashtinësë saj!* (Mesh. 237a).

Nga fusha e përemrave, me interes është forma e vetës së parë të përemrit vetor, numri njëjës, që del me trajtën *u*. Përemri *u* del në brezin shumë të moshuar, p.sh.: E ndiha *u* në punët e shtëpisë; të të thom të drejtën *u* s’mbaj mënt. Në një këngë popullore e gjejmë: I vanë lotët rëke/ *U* ja fshi, po s’kam me se (këngë popullore gjirokastrite dasme). Me këtë trajtë përemri, e folmja e Gjirokastrës ruan një gjendje shumë të vjetër, gjeografia e së cilës është e shtrirë më tepër në të folmet skajore të shqipës, si të folmet e tjera labe, të Himarës, të arbëreshëve të Italisë e të Greqisë, në çamërishte, si dhe në të folmet veriore të Nikaj-Mërturit, Dukagjinit, Lohes, Reçit e Buzë Ujit, Kelmendit dhe Hasit¹⁹. Te Buzuku: A e dini ju qish *u* juve bana? (Mesh. 219/a); Përse *u* juve thom se shumë përfetë...(Mesh. 291/b)

¹⁷ E. Çabej, po aty, f. 109.

¹⁸ E. Çabej, *Gjon Buzuku dhe gjuha e tij* në “Buzuku dhe gjuha e tij”, Tiranë, 2005, f. 108.

¹⁹ M. Totoni, *E Folmja e Bregdetit të Poshtëm*, SF, Tiranë, 1964, 1, f. 148; Q. Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, “Dialektologjia Shqiptare”, I, 1971, f. 172; E. Lafe, *E Folmja e Nikaj-Mërturit*, SF, 1964/3, f. 122; Gj. Shkurtaç, *E folmja e Rranxave të Mbishkodrës*, “Dialektologjia

Në këtë të folme, nuk dallohet gjinia e përemrit pronor, i cili del njësoj si për gjininë mashkullore dhe atë femërore, *djelmt e mi/ bilat e mi*. Edhe këtu e folmja e Gjirokastrës ruan një dukuri të vjetër e të konservuar. Këtë dukuri e ka vënë në dukje edhe E. Çabej: "... por në Gjinokastër thonë *motrat e mi*. Po të hapim autorët e vjetër, *mia* nuk ka, atje zotëron tipi *motrat e mi*"²⁰ E më tej do të shtojë në të mirë të këtij argumenti: "Në dialektin tim të Gjirokastrës... janë të gjalla edhe sot *duart e mi, vashast e tu*" Buzuku: Tÿ vetëmë rae ndë kat, e përpara ty bana keq përse u të jem gjukuom ndë *fjalët të tû*" (Mesh. 505/a); Hinjë se u thanë *eshënëat tonë* e shpënesa jonë u bduor (Mesh. 239/a), Përse *dittë e mī* erdhnë me porsi timi, e *eshënëatë e mī* porsi drutë e thatë u thanë. Kjo dukuri duket që është tipar i gjuhës së Buzukut dhe i shqipës së vjetër në përgjithësi, sepse në latinishte përemrat e mësipërm shfaqen me gjininë përkatëse: Quia defecerunt sicut fumus *dies mei*, et *ossa mea* sicut cremium aruerunt.

Përemri vetvetor *vetë* del në këtë të folme në trajtën e vjetër *vetëhe*. Buzuku: E thoshnë dishipujtë ndër *vetëhenë* (163/a).

Disa **veçori të sistemit foljor** në këtë të folme, na japin përshtypjen e një faze kalimtare, ku ndeshen rëndom në përdorim dukuri arkaike si dhe më të reja.

Për sa i përket pjesores së foljes, në të folmen e Gjirokastrës gjejmë ende përdorimin e prapashtesës së lashtë *-m* e cila është e rrallë në këtë të folme, sepse në toskërishte është zhdukur, kurse në gegërishte përdoret ende. Ajo gjendet te mbiemri prejpjesor, (*i, e*) *reme*, p.sh.: Sot kemi bërë gjellë të *reme* (pa mish); Gjendet, gjithashtu, në përdorimin e substantivuar "gënjeshtrë": Donin ta ndanin nusen për këtë punë, po qe *e reme*. (M. Kokalari: 179). Pjesorja e tipit më *-m* në Gjirokastrë, sipas Çabejt²¹ krahasuar edhe me greqishten më *men* në folje si (pheromenos, φερόμενος, i bartur, i sjellë) gjendet edhe në shprehjen *do të bëj një të pabëme*., (kërcënim nga dikush që ndodhet në vështirësi). E. Çabej, në një kumtim gojor dhënë Sh. Demirajt (Sh. Demiraj, Gram. 938) thotë edhe se në Gjirokastrë përdorej dikur

Shqiptare", IV, 1982, f. 208; *E folmja e Kelmendit*, "Dialektologjia Shqiptare", III, 1975, f. 45; Xh. Gosturani, *E folmja e Hasit*, "Dialektologjia Shqiptare", III, 1975, f. 231; Pino Siciliano, *Fjalorth i së folmes arbëreshe të Qanës*, "Dialektologjia Shqiptare", VI, 1990, f. 483; R. Memushaj, Helena Grillo, *Vendi i së folmes së Himarës në dialektin jugor të shqipës*, SF, 2009/1-2, f. 29-62.

²⁰ E. Çabej, po aty VII, Prishtinë, f. 121.

²¹ E. Çabej, po aty VII, Prishtinë, f. 121.

togfjalëshi *ditë e lëvruame* (ditë pune)²². Kjo prapashtesë gjendet rëndom te Buzuku, madje, siç vërejtëm më lart, është e gjallë në mbarë gegërishten e sotme. E në librin e parë gjejmë: Denjou u tÿ të të lëvdonj, o Virgjëna e *shëkruome* (Mesh. 17/a); Ki mishërier ñ meje, Zot, i biri i Davidit; bija ime fort anshtë *munduom* ñ dreqit (Mesh. 129/b).

Po kështu pjesoren e vjetër me prapashtesën *-të* e ndeshim si në librin e parë ashtu edhe në të folmen e Gjirokastrës ku ende është në përdorim, por vetëm te mbiemrat prejpjesorë, ashtu si dhe në të folme të gegërishtes veriore. Te Gjon Buzuku: ...se këto kafshë klenë *bātë* për të vërtetë (f. 225/b); ...fort trembunë e tue *klatë* u ndaj ñ si (75/b); Të sëmuniënë nukë vojte me e *pātë* (69/a) Tek Musineja: Penxheretë qenë *hapët*, dambano (180); Sitë nuk i mbante *ulët* e nuk lëshonin lotë (385).

Koha e pakryer e foljeve ndihmëse, mënyra dëftore, në të folmen e Gjirokastrës, nga pikëpamja historike ka mbaresa foljore të hershme të numrit njëjës: *kesh-ë, kesh-e, kish-, kesh-më, kish-të, kish-në* (kështu edhe për foljen *jam*): *S'kish* katër ditë martuar (M. Kokalari: 21), *S'kish* vënë gjë në golë...sikur *kish* lënguar gjithë. (M. Kokalari: 50) Kjo bëhet e qartë nga krahasimi edhe me librin e parë: ...u *jeshë* porsu ju renës (Mesh. 187/b); ...u t i *keshë* dhanë. (Mesh. 45/b); Ndë ditë të Erodit regjit Judesë *ish* një prift (Mesh. 327/b); E bij nuk *kishnë*, përse Elizabeta nuk mundë ban, e të dy *ishnë* pleq (Mesh. 327/b).

Në të folmen e Gjirokastrës dhe në gegërishten e vjetër ndeshet formimi i pësoremesores së foljeve me tingullin antihiatizues /n/ dhe jo me /h/. Nga Buzuku mund të sjellim shembuj si: Si mund të *banetë* këta (Mesh. 33/b); porsu *kthenetë* torenti ndë mjesëditët (Mesh. 21/b); Bani bē Zotynë e të mos *pëndonete* (Mesh. 25/a). Në Gjirokastrë: Hidh një gjëlpërë dhe *mendonesh* (M. Kokalari: 176); Këngë, këngë *këndoneshin e dëgjoneshin* na xhdo anë (M. Kokalari: 235). Folja e parregullt supletive *them*, në vetën e parë njëjës e shumës në të tashmen e mënyrës dëftore e lidhore del në këtë të folme në trajtën *thom, të thom, thomi, të thomi*: *S'të thom* se jo, moj Bedo. (M. Kokalari: 43); Ç'kam di qelqe me raki/ *thom* t'i pi /*thom* mos t'i pi (këng. pop.). Buzuku: A nukë *thomi* na se ti je Samaritan (Mesh. 187/b); për të vërtetë u juve *thom* (Mesh. 187/b).

Folja *vij* në vetën e tretë, mënyra dëshirore në këtë të folme del ende si në librin e parë. Ajo del në këtë trajtë në brezin e vjetër e në ndonjë këngë popullore: Kurë mos *artë*- tha teto Qibrua (M. Kokalari:399); Në mos *artë* proto muaj/mer shoqet e dil e luaj/në mos *artë* gjer në vjeshtë/mer urën e digj

²² Shembullin e fundit ne nuk e kemi ndeshur në Gjirokastrë, por kur ia kujton një të moshuari, pranon se *ashtu thuhej*.

leshtë... (këng. pop.) Në librin e parë: E aj *artë* përëmbi tÿ e me tÿ për jetë të jetësë, Amen. (Mesh. 79/a); M ty *artë* zani em (Mesh. 15/a).

Brezi i moshuar nuk përdor foljen *tregoj*, por *dëftoj*: ...s'ke një darkë bukë në shtëpi e më *dëfton* dhe xhepë, që ta di se si e ke (M. Kokalari: 37). Buzuku: e u të *dëftonj* vetëvetëhenë ati. (Mesh.263/b)

Si veçori sintaksore, do të veçonim paraqitjen pa shumë rregullsi në renditjen e fjalëve, tipar ky i ligjëritimit të thjeshtë, siç është veçanërisht ai i grave gjirokastrite por edhe i Buzukut që është pranë gjuhës popullore. Kur është fjala për qëllime stilistike sidomos për ekspresivitetet vihet re dukuria e paravendosjes së mbiemrit, p.sh. në Gjirokastrë: *Të madho gjum* që bën; *Të bukur të qarë* q'i ka bërë (M. Kokalari: 58); *Të tretën natë*, ajo i thotë djalit...(M. Kokalari:89) Buzuku: është ngritur ndër ne *e madhe turmë* (Mesh. 181/b); Ngrehu e ha, përse ke *të largë udhë* (Mesh. 89/b); Ose te pasthënia gjejmë: ...kjo tue klenë *ma e para vepër* (Mesh. 387/b).

S. Mansaku²³ që e ka parë këtë tipar te libri i parë e përjashton mundësinë e ndikimit të latinishtes, prandaj vëren se duket qartë që në asnjë rast nuk mund të behet fjalë për ndikim të tekstit latin, sepse togfjalëshave të shqipes mbiemër + emër në latinishte u përgjigjet një togfjalësh me rend të anasjelltë.

Një rend që s'përputhet me shqipen e sotme gjejmë edhe te forma analitike e së kryerës, ku folja ndihmëse del mbrapa foljes që mbart kuptimin kryesor, p.sh. në Gjirokastrë: *Pritur e përcjellur keshmë* gjithë jetën; Pastaj ku kanë qënë gazet dhe vdekëlat *vatur kishin*. (M. Kokalari: 400); Buzuku: E kush m'bë këtë mëndyrë ka fëjyem, *fëjyem ka* ndër parët kat të shqisevet. (Mesh. 67/a), ata që qish moti *ishnë klenë* ndër purgatuort zanë.(Mesh. 351/a).

Përshkruam më lart disa bashkëpërkime të gjuhës së librit të parë në shqipe "Mesharit" të Gjon Buzukut dhe së folmes së qytetit të Gjirokastrës. Sigurisht nuk pretendojmë t'i kemi parashtruar shterueshëm, por besojmë se ato që paraqitëm më lart, janë të mjaftueshme për të kuptuar se të folmet e veçanta ruajnë ende tipare konservative prandaj përherë paraqesin interes për studiuesit e shqipes.

²³ S. Mansaku, *Disa veçori morfo sintaksore të librit të parë në gjuhën shqipe*, "Buzuku dhe gjuha e tij", Tiranë, 2005, f. 353.

SUMMARY**ARCHAIC LINGUISTIC TOSK FEATURES OF GJIROKASTRA REGION
COMPARED TO OLD GEG LINGUISTIC FEATURES IN BUZUKU'S
*MISSALE***

Even today, the peculiar dialectical forms preserve eternalized features, which represent a crucial data resource for the History of Albanian Language. The existing resemblance, as well as the appearance of similar phenomena in these two dialects has been previously called to attention as an object of study by various scholars such as: M. La Piana, J. Rrota, G. Petrotta, G. Meyer, N. Jokli. Thereafter, the issue was reconsidered by E. Çabej, Sh. Demiraj, K. Topalli etc.

This study attempts to depict some corresponding linguistic particularities of the first book in Albanian language to the dialectical forms used in Gjirokastra town, owing to the greater number of similar archaic features of the two dialects noticed in the book "Missale" of Gj. Buzuku, amid old texts.

At first sight, it seems that the dialect of Gjirokastra and that one used by Buzuku in his "Missale" are distant in space and time, also they seem as they exceedingly belong to two distinct dialects. However, based on our observations, many similarities between old linguistic features of Tosk dialect in Gjirokastra and that one of geg region are present to the first Albanian book "Missale". In the other hand, although these old linguistic features of Gjirokastra town, found in Buzku's book, are still identifiable in the old generation, they are slowly fading away.